



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

## V E N D I M

**Nr. 174, datë 21.12.2020**

### **PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I GRANTIT TË RINDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, vendimin nr. 202, datë 05.03.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale”, të ndryshuar, vendimit nr. 160, datë 7.12.2020, të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rikonstruksionit/rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga aktekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh DS4 dhe DS5”, urdhrit nr. 11408/1, datë 25.03.2020, të kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programi i grantit të rindërtimit”, të ndryshuar, si dhe në vijim të Raportit të Komisionit të Posaçëm, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

### **V E N D O S I :**

1. Miratimin e raportit të komisionit të posaçëm për subjektet përfituese nga programi i rindërtimit, banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor 2019.
2. Miratimin e listës të subjekteve përfituese nga programi i grantit të rindërtimit, sipas aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Tabela e përcaktuar në pikën 1, të vendimit nr. 160, datë 7.12.2020, të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rikonstruksionit/rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh DS4 dhe DS5”, zëvendësohet me tabelën bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi. Në pikën 3, shtohet fjalia “Shuma e grantit të rindërtimit/rikonstruksionit në masën 60% të vlerës kalon në llogarinë e postës shqiptare, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit të listës së përfituesve”.
4. Subjektet përfituese të përcaktuara në pikën 2, përfitojnë vlerat e grantit të rindërtimit të parashikuara në tabelën e pikës 3, të këtij vendimi.
5. Përfitues të vlerave financiare të grantit të rindërtimit sipas parashikimeve të këtij vendimi janë edhe aplikuesit e shpallur fitues dhe të miratuara nga këshilli bashkiak, për të cilët nuk kanë filluar apo përfunduar procedurat e prokurimit publik për ndërtimin banesave të tyre nga Bashkia Tiranë.

**6.** Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike sipas parashikimeve të pikës 5, vendos në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale listën e subjekteve përfituese me qëllim përfitimin e shumave përkatëse të grantit të rindërtimit dhe zbatimin e procedurave të parashikuara në vendimin nr. 160, datë 7.12.2020, të Këshillit Bashkiak.

**7.** Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale njofton menjëherë njësitë administratave dhe lagjet për përfituesit që duhet të paraqiten për nënshkrimin e kontratave për përfitimin e grantit të rindërtimit.

**8.** Bashkia Tiranë ngarkohet të korrigjojë gabimet në rast se evidentohen në listat e përfituesve të përcaktuar në këtë vendim, si dhe në aktet e tjera të këshillit bashkiak që kanë për objekt shpalljen e listave fituese nga programet e rindërtimit. Korrigjimet i paraqiten këshillit bashkiak për miratim.

**9.** Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave në buxhetin e Bashkisë Tiranë.

**10.** Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Njësitë Administrative dhe Lagjet e Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R**

**ROMINA KUKO**

<b>Përbërja familjare</b>	<b>Struktura e banesës individuale</b>	<b>Vlera e grantit të rindërtimit</b>
Deri në 2 anëtarë	1+1	1,864,493 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre) lekë
3 deri në 4 anëtarë	2+1	2,181,998 (dy milionë e njëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë
5 e më shumë anëtarë	3+1	2,858,165 (dy milionë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë